



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	05.03.2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednitsa Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	1026/2021		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.86/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar shkesën A.nr.86/2021 të datës 18.02.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Ilaz Kodra" nr.3/8, Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit/Komuna e Skenderajt, në çështjen juridike "kompensimi material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.03.2021, mori këtë;

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.86/2021 e datës 18.02.2021, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.02-118/02-0048282/20, i datës 09.11.2020 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Skenderajt.
- III. Shfuqizohet Vendimi me numër 02-120/01-0052047/20, i datës 28.01.2021 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Skenderajt.

**A r s y e t i m**

Ankuesi me datë 18.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 703/2021 të regjistruar me numër A.nr.86/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 19.02.2021 ka



dërguar kërkesën për përgjigje tek Komuna e Skenderajt. Këshilli me datë 02.03.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegj për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokoll 703/2021 të regjistruar me numër A.nr.86/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 02-120/01-0052047/20 të datës 28.01.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën me numër protokoll 02-120/01-0052047/20 të datës 09.12.2020 drejtuar Komunës se Skenderajt; Vendimin me numër 02-118/02-0048282/20 të datës 10.11.2020 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoll 728/2021 të datës 19.02.2021; Përgjigja në ankesë me numër protokoll 891/2021 të datës 02.03.2021; Njoftimin e datës 29.12.2020 për paraqitjen e ankesës me numër 02-120/01-0052047/20 në Komunën e Skenderajt; Kërkesën e datës 11.11.2020 për pagesën retroaktiv; Dëshmi lidhur me pagesën e një page përcjellëse me rastin e pensionimit të nëpunësit civil; Vendimin me numër 020/04-0006349/19 të datës 04.02.2019 mbi emërimin e anëtareve të komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave: Grafiku i përvojës së punës sipas punëdhënësit: Shënime të përgatitjes shkollore e profesionale të ankuesit; Akt Emërimin me numër 112-379 të datës 03.05.2012; Vendimin me numër 112-463 të datës 30.05.2011;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimin me numër protokoll 112-379 të datës 03.05.2012 është konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në pozitën e punës Shef i Sektorit të Hyrave pran Komunës se Skenderajt, deri me datë 23.11.2020.

Njësia e Burimeve Njerëzore pran Komunës se Skenderajt, me datë 09.11.2020, ka nxjerr Vendimin Nr.02-118/02-0048282/20 për përfundimin e marrëdhënies së punës të ankuesit me datë 23.11.2020 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Me këtë vendim ankuesit i është njohur e drejta e realizimit të një pagë përcjellëse sipas dispozitave të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civil, të cilën pagë sipas shkresave të lëndës ankuesi e ka realizuar me listën e pagave të muajit nëntor 2020.

Me datë 09.11.2020 ankuesi ka parashtruar ankese pran Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Skenderajt, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin edhe të dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë. sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive në Kosovë.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 28.01.2021 ka nxjerr Vendimin Nr.02-120/01-005247/20 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka lenë në fuqi Vendimin Nr.02-118/02-0048282/20 të datës 09.11.2020 të Njesisë se Burimeve Njerëzore, përmes të cilit ankuesit i është njohur vetëm një page përcjellëse me rastin e pensionimit.

Kundër Vendimit Nr.02-120/01-005247/20 të datës 28.01.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi me datë 18.02.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes së ligjit dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke kërkuar që të anulohet vendimi i Komisionit për

Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe të njëjtit t'i njihet e drejta e realizimit të dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë për përvojë pune.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për njohjen e të drejtës për realizimin edhe të dy (2) pagave përcjellëse dhe tri (3) pagave jubilarë, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, Kolegji konstaton se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në gazetën zyrtare me datë 18.06.2014, me Nr.38/2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe ka qenë e zbatueshme vetëm deri me datë 01.01.2018 siç përcaktohet me nenin 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-2012 të Punës, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit në këtë kuptim janë të pa bazuara, andaj Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në pikën 1 të dispozitivit të këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me këtë çështje ka analizuar legjislacionin e aplikueshëm për Shërbimin Civil dhe ka konstatuar se çështja e pagave, shtesave në page dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil janë të rregulluara me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Page dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civil, ku bazuar në dispozitat e nenit 19 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Page dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji ka konstatuar se nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njehershme në vlerën e pagës së tij të fundit, dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson se organi i punësimit, respektivisht Komuna e Skenderajt ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.02-118/02-0048282/20 të datës 09.11.2020, përmes të cilit ankuesit i ka njohur të drejtën e kompensimit të një page përcjellëse me rastin e arritjes së moshës së pensionimit.

Bazuar në Aktgjykimin me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Kolegji ka konstatuar se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020, dhe i njëjti, me dispozitat e neni 32 paragrafi 3 ka përcaktuar, se: *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji*, ndërsa neni 85 ka shfuqizuar Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj, andaj si rrjedhojë Kolegji vlerëson se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave pran Komunës së Skenderajt, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.02-120/01-0052047/20 të datës 28.01.2021 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të këtij ligji nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, kështu që Kolegji duke u bazuar në nenin 52 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 dhe 1.5 si dhe nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në pikën 3 të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me ligj, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda numër A.nr.86/2021

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Skenderajt;
- Arkivit të KPMSHCK-së

